



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601536/6

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet vendosja e kamerave në IEVP Peqin që të monitorojnë ambjentin e qëndrimit të grupit të sigurisë dhe rrugën ndërmjet godinave të të burgosurve që çon në këtë ambjent*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Miklovan KOPANI

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të IEVP Peqin
Z. Eugert SALLA

PEQIN

I nderuar Zoti Kopani,

Në zyrën e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e të dënuarit A. Z., i cili pretendon se, në datën 15.06.2016, është dhunuar fizikisht nga disa punonjës të policisë në ambjentin ku qëndron grupi i sigurisë. Për verifikimin e këtij rasti kemi kryer disa veprime hetimore në IEVP Peqin, në përfundim të të cilave nuk është provuar pretendimi i të dënuarit.

Një nga veprimet e kryera për verifikimin e kësaj ankese ishte njohja me pamjet filmike të kamerave të sigurisë. Nga ky veprim u konstatua se, në ambjentin e qëndrimit të grupit të sigurisë, ku pretendohet se është ushtruar dhunë fizike nuk kishte kamera të sigurisë. Ky ambjent ndodhet në godinën që përdoret edhe për takimet e të burgosurve me avokatin. Sipas shënimeve në librin e hyrje-daljeve dhe deklarimeve të shefit të policisë, i dënuari A. Zh. është shoqëruar në këtë ambjent në datën 15.06.2016, për të marrë takim me shefin e regjimit pasi ky i dënuar atë ditë kishte kryer disa veprime të ndaluara. Meqenësë në këtë ambjent kryhen veprime me të burgosur gjykojmë se ai duhet të monitorohet me kamera. Momenti i shoqërimit të të dënuarit A. Zh. nga godina ku ndodhen dhomat e veçimit për në ambjentin ku pretendohet se është ushtruar dhunë fizike nuk janë fiksuar në kamera, pasi ambjenti ndërmjet këtyre godiave monitorohet vetëm nga një kamera e lëvizëshme që rrotullohet 360 gradë, pamjet e të cilës ruhen për një kohë të shkurtër. Kjo kamera është

vendosur në vendrojen nr.1 që ndodhet në murin rrethues të sigurisë perimetrike. Gjykojmë që edhe në këtë vend të ketë një kamera fikse që të monitorojë ambjentet ndërmjet godinave.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha ambjenteve në IEVP, përveç atyre ambjenteve që çënojnë privatësinë, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambjenteve të burgjeve dhe paraburgimeve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

Vendosjen e një kamera në ambjentin ku qëndron grupi i sigurisë dhe të një kamera fikse në vendrojen nr.1 që të monitorojë ambjentin ndërmjet godiave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nein 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI